

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	REL: Rusia rikthehet në bazat e veta në Siri
ADRESA	https://dosja.al/bota/rel-rusia-rikthehet-ne-bazat-e-veta-ne-siri-i514155
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 20:43:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:43:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d83232b4c718dc3863c3852ad9a614184cc623fb85160955de08a8c9821f1d23
TEKSTI	6a35d729b2c2d44661424998f10b213c732eb332d038decba2065d844dc87ea3
PAMJA	9008adbab16ef2a018b0dc53966e5208974a03b74768049dc9122f71a558b521

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1684c955b63af8f0556aebb24a0914e5ab577e8d2d13ebcdbe3ab6234f8877bc
E MËPARSHMJA	43a882250d0d180119681fb3c392d12a2f035aa3093215af15ad384bc3177da7
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1684c955b63af8f0556aebb24a0914e5ab577e8d2d13ebcdbe3ab6234f8877bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

3 ORE ME PARË

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

3 ORE ME PARË

Më 16 shtator jepet vendimi për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

8 ORE ME PARË

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

11 ORE ME PARË

Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

Bota

REL: Rusia rikthehet në bazat e veta në Siri

Një flotë prej tri anijesh ruse, të shoqëruara nga një anije shkatërruese e marinës, u pa për herë të parë duke lundruar drejt jugut, në brigjet e Spanjës, në fund të gushtit.



14 Shtator 2026, 22:43
Nga G.M



foto ilustruese

SIRI- Një muaj pasi u tha se bazat e Rusisë në Siri do t'i "dorëzoheshin" Damaskut, anijet ushtarake ruse janë rikthyer në portin e Tartusit, konfirmojnë imazhet ekskluzive të siguruara nga Radio Evropa e Lirë (REL).

Një flotë prej tri anijesh ruse, të shoqëruara nga një anije shkatërruese e marinës, u pa për herë të parë duke lundruar drejt jugut, në brigjet e Spanjës, në fund të gushtit. Destinacioni i deklaruar i autokolonës detare ishte Egjipti, por menjëherë pasi kaluan Ngushticën e Gjibraltarit, anijet i fikën transponderët për të shmangur gjurmimin e tyre.

Një imazh i publikuar në llogarinë "Russian Forces Spotter" në X tregon flotën ruse duke lëvizur në drejtim të jugut përgjatë bregdetit spanjoll, gjatë rrugës së saj për në Siri në fund të muajit gusht. Imazhet e siguruara nga REL-i, të shkrepura në fillim të shtatorit, konfirmojnë se flota është ankoruar së fundi në portin sirian të Tartusit për të shkarkuar një ngarkesë të panjohur.

Imazhet, të cilat nuk ishin publikuar më parë, duket se kundërshtojnë pretendimet zyrtare se pjesa e objektit të Tartusit, e cila më herët ishte nën kontrollin rus, i ishte dorëzuar Sirisë për përdorim civil. Anijet që shihen në imazhet nga Tartusi janë anija shkatërruese e marinës, Admiral Levchenko, Sparta, një anije ushtarake logjistike, dhe Akademik Pashin, një anije furnizuese e projektuar për furnizimin e anijeve të tjera në det. Anija e katërt e flotës, cisterna e naftës, General Skobelev, nuk duket në imazh.

Ankorimi i anijeve ruse mbështet vlerësimet e analistëve se pazaret e ftohta gjeopolitike ia kanë mundësuar Kremlinit t'i mbajë bazat e tij në Siri, edhe pse deklaratat zyrtare duket se janë formuluar në mënyrë të tillë që të sugjerojnë të kundërtën.

"Udhëheqjes së re të Sirisë i duheshin gjëra që vetëm Rusia mund t'i ofronte", tha për REL-in Ruslan Trad, analist për çështjet e Sirisë. Ndër faktorët e tjerë, rezervat e armëve të Sirisë janë kryesisht ruse dhe Damaskut "i duhet t'i rimbushë depot", tha Trad.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 22:25

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të trondisë raportet e Kosovës me Perëndimin

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 20:43

Pesë shkolla në Astir? Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 20:09

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Çështja: Hetimin

Presidenti i Sirisë, Ahmed al-Sharaa, kishte udhëhequr një grup rebel gjatë luftës civile në vend, i cili ishte shpesh objektivi i bombardimeve ruse, ndërsa Kremlin i përpiqej të mbështeste ish-udhëheqësin sirian Bashar al-Assad. Në vitin 2017, Moska pretendoi se kishte plagosur al-Sharaan në një sulm ajror.

Assad u rrëzua nga pushteti në dhjetor të vitit 2024 dhe forcat ruse që po evakuheshin nga Siria në atë kohë u goditën me gurë teksa largoheshin nga bastionet e tyre nëpër vend. Në janar të vitit 2025, autoritetet e reja siriane i dhanë fund qirasë 49-vjeçare të Moskës për pjesën veriore të portit, e cila ishte e rezervuar për anijet ruse.

“Në përgjithësi, rusët bënë një bast të keq duke mbështetur Assadin, por më pas e luajtën dorën e tyre mjaft mirë dhe armiqtë e tyre sirianë rezultuan të ishin shumë pragmatikë”, tha Aron Lund, analist për Lindjen e Mesme në Agjencinë Suedeze të Kërkimeve të Mbrojtjes.

“Nafta dhe gruri rus e kanë ndihmuar Sirinë të qëndrojë në këmbë gjatë trazirave ekonomike”, ndërsa “votat ruse në OKB kanë mundësuar heqjen e udhëheqjes aktuale të Sirisë nga listat e OKB-së për terrorizmin. Dhe, natyrisht, bashkëpunimi sirian i ka mundësuar Rusisë t’i mbajë bazat e saj”, tha Lund, duke shtuar se objektet “mund të jenë duke funksionuar tani në një formë të kufizuar”.

Tartusi është baza e vetme detare ruse jashtë ish-Bashkimit Sovjetik dhe është një qendër kyç furnizimi për praninë ushtarake të Kremlinit në Afrikë. Objektet alternative të mundshme në Libi dhe Algjeri kanë infrastrukturë më pak të zhvilluar dhe do të kërkonin marrëveshje të ndërlikuara diplomatike, përfshirë me Turqinë.

Një raport i qershorit nga Shërbimi rus i REL-it tregoi se baza ajrore Khmeimim, pika e dytë kryesore e pranisë ruse në Siri, vazhdon të përdoret nga avionët e Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë që fluturojnë drejt Malit dhe vendeve të tjera afrikane. Korpusi Afrikan i Rusisë po përpiqet të ndihmojë ushtrinë e Malit të rimarrë kontrollin e zonave në veri të vendit, të mbajtura nga rebelët tuaregë dhe grupet xhihadiste.

Imazhet e fundit satelitore të bazës ajrore tregojnë se në bazë po zhvillohen punime të mëdha ndërtimore. Siria dhe Rusia kishin deklaruar se baza Khmeimim do të presë një “qendër të përbashkët trajnimi dhe rehabilitimi”./REL

rusi rel

Sondazh

Poll

Belo

14 Shtator 2026, 22:20

Greqia kërkon heqjen e imunitetit të eurodeputetit socialist Nikos Papandreu

Nikos Papandreu GREQI- Autoritetet greke i kanë kërkuar Parlamentit Evropian heqjen e imunitetit nga ndjekja penale për eurodeputetin social...

rammjalet e tij. Graça. Motem ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

më të klikuarat

- 

“Te q***a robt, o Edi”/ Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)
- “Mbaje mend do të vras”/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale
- Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatricë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim
- Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit

insights

- Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen
- Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?
- Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?
- Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow

Konflikti me Rusinë/ Zelensky: Ukraina gati të ndalë sulmet, kërkojmë garanci për mbrojtjen e infrastrukturës

Beta

14 Shtator 2026, 22:05

Konflikti në Lindjen e Mesme/ Trump: Irani kërkon me dëshpërim marrëveshje për ti dhënë fund luftës

Beta

14 Shtator 2026, 21:58

"I shërbeva me besnikëri popullit"/ Vuçiç njofton datën e largimit nga posti i presidentit: Do të jap dorëheqjen më 27 shtator

Beta

14 Shtator 2026, 21:22

Zelensky kërkon shkarkimin e prokurorit të përgjithshëm të Ukrainës pas një skandali të ri

Beta

14 Shtator 2026, 21:08

Beta

14 Shtator 2026, 18:30

“Ne jemi përpara Kinës”/ Trump sulmon CEO-n e Anthropic: Zhvillimi i IA-së nuk ka nevojë të ngadalësohet

Donald Trump SHBA- Presidenti amerikan Donald Trump ka sulmuar publikisht CEO-n e Anthropic, Dario Amodei, pas deklaratave të tij për nevojë...

Panik në Libi, avioni privat i miliardarit turk del nga pista gjatë uljes dhe përfshihet nga flakët, pezullohen fluturimet (VIDEO)

Bota
14 Shtator 2020, 18:30

Konflikti në Lindjen e Mesme/ Netanyahu: Izraeli do të vazhdojë shkatërrimin e infrastrukturës së Hezbollahut në Liban

Bota
14 Shtator 2020, 18:15


Samiti BE-Arktik/ Kallas: BE kërkon më shumë akullthyes për të forcuar praninë në Arktik

Bota
14 Shtator 2020, 17:35

"Po ekspozon jetën e njerëzve"/ OKB kërkon ndërhyrje urgjente për rregullimin e Inteligjencës Artificiale

Bota
14 Shtator 2020, 16:53

MË SHUMË



Përfundojnë fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë drejt bllokut të sigurisë



Përfundojnë fjalimet para
Kryeministritë, qytetarët
marshojnë drejt bllokut të
sigurisë

Pagat e magistratëve/ Braçe
i ashpër me KLGJ dhe KLP:
Në thesarin e shtetit nuk fut
dorën kushdo

Braçe kritika të ashpër ndaj
KLGJ dhe KLP për vendimet
për pagat: Të kërkojnë falje

Berisha: Trump denoncoi
rrezikun komunist dhe
rrezikun e drogës, mbi të
cilat qëndron regjimi i
Durrës

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT

Drejtor: Enton Abilekaj
Kryeredaktor: Izmir Akulli
Gazetarë:
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj

[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)MUNDËSHKAR NGA  Mediadesk**ART&ARGËTIM****INSIGHTS****EDITORIAL**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.